

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2721 Prot.

Durrës, më 21. 11. 2025

VENDIM

Nr. 90, datë 21. 11. 2025

**"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA SHTESA DHE NDRYSHIMEVE NË
STATUTIN E UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" nenit 49 pika 1 gërma gj, nenit 34 pika 1 të Statutit të UAMD, shkresës nr.2567/1 prot, datë 18.11.2025 të GVB-së, Bordi i Administrimit ,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të disa shtesa dhe ndryshimeve në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim përcillet për miratim përfundimtar Senatit Akademik.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Neni 8 "Struktura e Universitetit", ndryshon pika 1 dhe pika 2, si dhe shtohet me pikën 3 dhe pikën 4.

Neni 8 ishte:

1. UAMD përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga pesë njësi kryesore, të cilat përbëhen nga njësitë bazë. Njësitë kryesore të UAMD janë fakultetet, ndërsa njësitë bazë të tij janë departamentet.
2. Në përbërje të Universitetit janë Fakulteti i Biznesit (FB), Fakulteti i Edukimit (FE), Fakulteti i Shkencave Politike Juridike (FSHPJ), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP).

Neni 8 Bëhet:

1. UAMD përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësitë kryesore, njësitë bazë dhe qendrat kërkimore/ studimore. Njësitë kryesore të UAMD janë fakultetet, njësitë bazë të tij janë departamentet.
2. Në përbërje të Universitetit janë pesë njësi kryesore: Fakulteti i Biznesit (FB), Fakulteti i Edukimit (FE), Fakulteti i Shkencave Politike Juridike (FSHPJ), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), Fakulteti i Studimeve Profesionale (FSP).
3. UAMD ka në përbërje tre qendra: Qendra për Trashëgiminë Kulturore Mesjetare, Qendra për Kërkim dhe Ekselencë, Qendra e Studimeve Ndërdisciplinore. Funksimi i tyre përcaktohet në Rregulloren e UAMD-së, si dhe në rregulloret e tyre të brendshme.
4. Struktura e UAMD-së pasqyrohet në Oranigramë, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij Statuti.

Neni 21 "Zëvendësrektori", ndryshon pika 2 dhe shtohet gërma d),

Neni 21 ishte:

1. Zëvendësrektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe i përkasin kategorisë "Profesor" ose kanë gradën shkencore "Doktor" ("PhD") të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata emërohen dhe shkarkohen nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.
2. Në UAMD ka tre zëvendësrektorë:
 - a) Zëvendësrektori për anën mësimore, i cili mbikëqyr zhvillimin e procesit akademik në UAMD;
 - b) Zëvendësrektori për kërkimin shkencor, i cili mbikëqyr zhvillimet kërkimore shkencore në UAMD.
 - c) Zëvendësrektori për çështjet institucionale, i cili kujdeset dhe mbikëqyr zbatimin e strategjisë së zhvillimit të institucionit, dhe çështje të tjera që përcaktohen nga rektori.

1. Zëvendësrektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë dhe i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PhD”) të fituar në universitete të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Ata emërohen dhe shkarkohen nga rektori, pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij në Senatin Akademik.

2. Në UAMD ka **katër** zëvendësrektorë:



- a) Zëvendësrektori për anën mësimore, i cili mbikëqyr zhvillimin e procesit akademik në UAMD;
- b) Zëvendësrektori për kërkimin shkencor, i cili mbikëqyr zhvillimet kërkimore shkencore në UAMD.
- c) Zëvendësrektori për çështjet institucionale, i cili kujdeset dhe mbikëqyr zbatimin e strategjisë së zhvillimit të institucionit, dhe çështje të tjera që përcaktohen nga rektori.
- d) **Zëvendësrektori për ndërkombëtarizimin, i cili ndjek të gjitha çështjet që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar të UAMD-së.**